

**EVALDA PACI****VARIANTE TË HERSHME DOKTRINARE NË NJË KONTEKST  
TË HISTORISË SË LETËRSISË SË SHKRUAR SHQIPE**

Periodizimi i historisë së letërsisë së shkruar shqipe iniciohet me të drejtë me marrjen parasysh të kontributeve që nuk përbëjnë vetëm dokumente shkrimore të shkëputura në pikëpamje përmbajtjeje dhe plotësie tekstore. Të tilla tekste janë parë me vëmendje nga kritikët dhe studiuesit e letërsisë së shkruar shqipe, por dhe nga historianë dhe gjurmues të burimeve më të hershme shkrimore që hedhin dritë si mbi historinë e kombit tonë, ashtu dhe mbi rolin e personaliteteve që duke u paraqitur si lëvrues një kulture specifike shkrimore në gjuhën tonë, bëjnë pjesë në një mozaik historik që u shënuar ndjeshëm dhe nga kontributi i tyre, sa konkret aq dhe i pashlyer.

Letërsia e shkruar shqipe shënohet dhe nga vepërza që janë paracaktuar të jenë doracakë doktrinarë që do t'i shërbenin praktikës së rëndësishme të liturgjisë së përditshme dhe besimit të krishterë në viset tona. Një traditë e konsiderueshme gjurmimesh u njeh dhe këtyre botimeve e varianteve të tyre mjaft vlera në disa pikëpamje dhe evidentimi i tyre dëshmohet në mjaft studime tematike mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe. Vitet e fundit hulumtimi mbi tekstet përkatëse të këtyre vepërzave është shtrirë më gjerësisht duke qenë se janë përpiluar botime kritike dhe filologjike që kanë mundësuar dhe lehtësuar për afrimin me përmbajtjen dhe elemente qenësore të brendisë së këtyre teksteve. Të afërta në kohë dhe me vepra më të mëdha në pikëpamje ndërtimi siç paraqitet dhe Dicionari latinisht-shqip i vitit 1635 i përpiluar nga Frang Bardhi, është e mundur të gjurmohen dhe në lidhje me to tipare të shtypshkrimit por dhe të konceptimit të një metodologjie të përafërt në drejtim të transkribimit apo tejshtypimit të mirëfilltë filologjik të tyre, me një perspektivë dhe të plotësimit me shënime tekstore që i shërbejnë një studimi më të thelluar të përmbajtjes përkatëse.

Një vijimësi e natyrshme në drejtim të hulumtimit të praktikës liturgjike në tekste të botuara dhe të shtypura mund të ndiqet që nga realizimet e Pjetër Budit (1618-1621), prelatit që u bë objekt interesi nga studiues të historisë së letërsisë së shkruar shqipe, ndërkohë që vepra dhe shkrimtaria e tij qëndron mes prurjeve terminologjike që mund të quhen të iniciuara me pjesë specifike të përfshira në librin e Gjon Buzukut (1555) dhe atyre që vijojnë të ndjekin një rrugë konsolidimi në sprovat të mëvona që u ndërmoren si nga meshtarë vendës, ashtu dhe të huaj. Përbën një fakt i tillë një panoramë të pasur në elemente jo

vetëm të leksikut të konkretizuar, duke qenë se të tilla sprova mbeten dëshmi e vijimësisë së përpjekjeve për të edukuar ndaj besimit të krishterë dhe me variante librash e veprash të shkruara. Është shkruar jo pak në lidhje me shkrimtarinë e kontributet në letërsinë e shkruar të Pjetër Budit, duke qenë se përpilimet e tij në pikëpamje të realizimit kohor përkojnë dhe me iniciimin e varianteve të ripara në drejtim të përmbajtjes dhe të teksteve specifike që duhet të përmbanin, ndërkohë që veçanërisht tradita shqiptare e studimeve në fushë të historisë së shkrimit shqip dhe të historisë së letërsisë së shkruar shqipe i njeh këtij autori merita të shumta në çështje të lëvrimin të një metri specifik në komponimin e strukturës poetike të përpilimeve të tij dhe vlera të tjera që lidhen me aspekte të pasqyrimin të elementeve të botës shqiptare përmes kësaj krijimtarië.

Larmia e varianteve të sjella nga autorë të ndryshëm vë në dukje faktin që jo gjithmonë është ndjekur një linjë e vetme në përcaktimin strukturor të varianteve doktrinare që realizohen nga Gjashtëqinda e më tej, ndërkohë që çdo gjurmim i vëmendshëm ndaj secilit prej tyre mund të shpjerë dhe në vënien re të jetëgjatësisë së përdorimeve që dhe sot e kësaj dite mbeten themelore në një regjistër gjuhësor specialistik si ai i liturgjisë. Vetë gjuha shqipe projektohet në një sërë perspektivash pothuaj në çdo rast të realizimit të varianteve të tilla. Vëzhgime mbi sistemin mbiemëror të shqipes, mbi klasat emërore që dëshmojnë për prani të analitizmit dhe sintetizmit në përdorime dhe terma specifike që bëhen objekt përdorimi në këto variante, evidentime sintagmash dhe frazash që dëshmojnë dhe origjinalitet me format në të cilat shfaqen në tekste të veçanta bëhen të mundura duke pasuruar një panoramë kryesisht diakronike të studimit të nënsistemeve të gjuhës sonë.

Duket qartë që doracakët doktrinarë që realizohen në një periudhë që kapërcen dy shekuj e që janë konkretizuar dhe pas përfundimit të punimeve të Koncilit të Arbënit (1703), përmbushin një mision të rëndësishëm në pikëpamje të transmetimit të një terminologjie që sigurisht mund të përmbahet dhe në libra kanonike të përmasave më të konsiderueshme, duke qenë këta të fundit të paracaktuar të përmbajnë dhe të tjera tekste e sigurisht me një tjetër shtrirje në pikëpamje të integritetit përmbajtësor. Këta doracakë, në dukje modestë në vëllim karakterizohen në shumicën e rasteve nga një qartësi e dukshme në ndërtimin dhe nënndarjet mbi të cilat janë konceptuar. Veçojmë në këtë pikëpamje realizimet e njëpasnjëshme të Imzot Ndre Logorecit, ndërkohë që duhet nënvizuar dhe fakti që disponimi i disa varianteve doktrinare të përpiluara e të kujdesuara prej tij mundëson dhe sot e kësaj dite ndërmarrjen e analizave filologjike e tekstore që bëjnë të mundur të dallohen veçori dhe përkime mes teksteve të varianteve në fjalë. Çdo variant i kësaj natyre ka qenë shtysë dhe për ndërmarrjen dhe përpilimin e modeleve të tjera veçanërisht në fillim të shekullit të kaluar dhe një dëshmi e këtij fakti mbeten dhe përdorimet e ruajtura me kujdes në

doracakë e të përkohshme me destinacion liturgjik të përgatitur nga personalitete si Dom Ndre Mjedja, Atë Jak Junku S.I., etj. Duhet nënvizuar dhe në këtë rasë që kontributet e Dom Ndre Mjedjes dhe prania e Atë Jak Junkut S.I. si revizor dhe mbikëqyrës i mjaft botimeve të tilla, bashkë me doracakë mjaft të përdorur në atë kohë e që kanë pasur përkujdesjen e Atë Justin Rrotës O.F.M. dëshmojnë në mënyrë konkrete sa njëjtoj tradita e sipërcituar e realizimeve të mirëfillta doktrinare, ndërkohë që kujdesi për të ruajtur sa më shumë të ishte e mundur elemente kryesisht terminologjike nga këto prova lexohet e ndiqet qartë nga njëri botim në tjetrin.

Një doracak mjaft me interes për historinë e shkrimit shqip, por dhe të asaj të besimit të krishterë në viset shqiptare mbetet Compendiumi doktrinar i Gjon Nikollë Kazazit, që pa dritën e shtypit në vitin 1743, nën siglën botuese të Kongregacionit të Propagandës së Fesë. Natyrshëm dhe në çdo rrethanë e veçanërisht kur bëhet fjalë për një personalitet si Imzot Kazazi vëmendja orientohet nga fakti që ai i ka kushtuar rëndësinë e duhur ekzistencës së një ekzemplari mjaft të veçantë për liturgjinë e orëve (*Mesharit*) në një periudhë të afërt me realizimin e manualit të tij të sipërcituar, ndërkohë që po me të drejtë me emrin e tij lidhet dhe referimi ndaj tekstesh specifike që ai veçoi të interpretonte dhe të tejshkruante nga libri i Gjon Buzukut në proces të letërkëmbimeve me eprorë të institucioneve të edukimit e formimit kishtar të kohës. Shfaqja e një interesi të gjallë nga ana e një prelati të kishës së Romës siç ishte Gjon Nikollë Kazazi ndaj ekzistencës së modeleve të tilla vijon natyrshëm çka parashtrahet dhe në sinode kishtarë që u prijnë në kohë ndërmarrjeve të tij për të kontribuar dhe me sprovat të vyera për praktikën e liturgjisë dhe të besimit në zonat ku ushtronte aktivitetin baritor. Siç është theksuar dhe në shkrime të mëparshme tonat në lidhje me kontributin e çmuar të këtij prelati të kishës shqiptare, por dhe me merita të pamohueshme autorësie në variantin doktrinar që hartoi dhe përpiloi në një mënyrë që e dallon mirëfilli nga të tjerë autorë paraardhës, përdorimet e përveçme që ky i fundit përuroi në mënyrë origjinale dhe me vetëdijen se do t'i shërbenin një përmbajtjeje specifike si ajo e një doracaku praktik e fetar do të vijojnë të jetojnë e të jenë elemente funksionale që u morën të mirëqena dhe në botime të mëvona që u përpiluan kryesisht nga meshtarë të huaj e që ndërmorën të hartonin sprovat të ngjashme në gjuhën tonë. Veçantia autoriale e Imzot Gjon Nikollë Kazazit dëshmohet pothuaj në çdo element të doracakut doktrinar të vitit 1743, ndërkohë që një sërë sintagmash që ndeshen në faqet e këtij të fundit do të kthehen në mjete të rëndësishme shprehësie në autorë të mëvonë që shihet se janë përherë në përpjekje për të njohur më mirë dhe më thellë një historik shkrimi që në raste të përpilimit të sprovave me karakter liturgjik dhe të praktikës fetare paraqitej më se i domosdoshëm.

Çdo vepër që shërben për të rindërtuar një periudhë kohore që kapërcen dy shekuj e që ka të bëjë me letërsinë e vjetër shqipe dhe me monumentet më të hershme shkrimore të gjuhës sonë është një realitet sa i veçantë, aq dhe kompleks duke qenë se te secila është e mundur të lexohet një përpjekje e lavdërueshme për t'i shërbyer një kauze të rëndësishme që ngërthen njëherësh lëvrimin e shkrimit në gjuhën tonë, por dhe historinë e besimit dhe të botimit të librave të veçantë, rëndësia e të cilëve nuk përcaktohet nga vëllimi, por nga brendia pothuaj çdo herë e kujdesuar dhe që dëshmon se dashuria për gjuhën dhe për dheun mëmë përkthehet dhe në të tilla sprova shkrimi, sa dinjitoze, aq dhe serioze.

Vepërza e Imzot Kazazit paraqitet e thjeshtë në elementet që e përbëjnë, por nga vëzhgimet mbi përmbajtjen dhe renditjen e elementeve themelore të ndërtimit të saj bindemi se dhe ky botim do të shërbente më së miri për të përforcuar një traditë që kishte nisur kohë më parë, qoftë dhe me libra që kanë ndjekur modele të ndryshme në strukturën përkatëse, por nuk janë të diferencueshëm ndjeshëm nga doracakët doktrinarë duke qenë se u janë referuar fushave të ngjashme semantike dhe kanë pasur si modele gjegjëse dhe emërtesa të të njëjtit destinacion gjatë shtjellimit të përmbajtjes së tyre.

Në kuadrin e një panorame tërësore të botimeve me destinacion ndaj praktikës së liturgjisë dhe edukimit katekistik që nga realizimet e sipërcituara të Pjetër Budit e më vonë, *Doktrina e kërshenë* apo Compendiumi i sipërcituar i Gjon Nikollë Kazazit zë një vend të përveçëm dhe një fakt i tillë përforcohet dhe nga studime e kërkime mbi personalitetin e tij që hedhin dritë mbi angazhime të shumta të natyrës baritore. Vepra të tilla bëhen më të afërta në rastet e përafrimit të tyre në dimensione botimesh kritike e filologjike<sup>1</sup> dhe në rastin e Kazazit një fakt i tillë jo vetëm ka dëshmuar se të tilla vepra angazhojnë filologun e tekstit në një sërë dimensionesh e kërkimesh, por dhe bëjnë të mundur të ndiqet një ecuri dhe në kulturën e shkrimit që nga një autor në tjetrin ka pësuar ndryshime, por ka pasur dhe vijimësi të natyrës logjike.

Kur bëhet fjalë për doracakët doktrinarë që pasuan në kohë zhvillimin e Koncilit të Arbënit (1703), emri i Imzot Gjon Nikollë Kazazit mbetet një referencë themelore për nga rëndësia e kontributit, por dhe nga momenti domethënës në të cilin sheh dritën e shtypit ekzemplari sintetik i realizuar prej tij. Janë një sërë përdorimesh që tërheqin vëmendjen në përbërjen e këtij varianti, mes të cilave dhe disa elemente më të përveçme ndaj të cilave Kazazi ka qenë i qartë në pikëpamje të përzgjedhjes dhe të konotacionit që u kishte deleguar. Për sa mund të konsiderohet bindshëm si vijues i disa tipareve shkrimore që ndeshen më parë dhe në autorët që përfaqësojnë letërsinë e vjetër shqipe, po aq e rëndësishme është dhe të vihet në dukje që

<sup>1</sup> B. Demiraj, *Gjon Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.

ky autor dhe përpilues lë gjurmë me inovacione në fushë të përdorimeve që janë themelore për konceptimin e praktikës së liturgjisë dhe figurave bazilare të saj.<sup>2</sup>

Një kuadër i tillë ka vijuar të përmbushet në kohë me të tjera sprova që janë pothuaj të gjitha dëshmi e një angazhimi të fortë të autorëve a përpiluesve dhe në drejtim të shprehjes së një lidhjeje të fortë shpirtërore me viset në të cilat shërbenin dhe kryenin misionin meshtarak. Variantet që në disa raste janë shtypur dhe në formate dygjuhëshe (Atë Zef Guagliata S.I.; Romë, 1845) kanë qenë dhe mbeten dëshmi e njohjes nga ana e autorëve të kontekstit në të cilin operonin e në rastet kur këta të fundit nuk kanë qenë shqiptarë, veçantitë përbëjnë një tjetër vlerë për t'u konsideruar e marrë në shqyrtim nga disiplina e filologjisë së tekstit. Në veçanti përpilimi i botuar dhe i ribotuar vite më vonë i Atë Zef Guagliatës S.I., doracaku i ngjashëm me të i përbërë nga lutje dhe tekste themelore kishtarë *Ruga e Parrisit*, i përgatitur e botuar nga Atë Vinçens Basile S.I. në vitin 1845 (Romë, Të sctampùemin të t'Scëitit Cuvén de Propaganda Fide), por dhe variantet e sipërcituara të Imzot Ndre Logorecit (1880; 1886 etj.) janë dhe burime nga të cilat vilen veçori përdorimesh që kanë të bëjnë me të folme dhe zhvillime gjuhësore specifike të gjuhës shqipe të kohës në të cilën jetonin autorët në fjalë. Janë po këta autorë që natyrshëm bënë të rijetonin elemente që së pari çdo gjurmues i teksteve të vjetra shqipe i gjen në autorët e parë të letërsisë së vjetër shqipe dhe në dëshmitë më të hershme shkrimore të gjuhës shqipe.

Natyra didaktike e këtyre botimeve është e kuptueshme dhe po të kihet parasysh përkujdesja e vazhdueshme që pas përfundimit të punimeve të Koncilit të Trentit u shpreh ndjeshëm dhe në çdo mënyrë ndaj përmbajtjes dhe shprehjes së qëllimit brendësues të tyre, ndërkohë që paralelisht me këtë panoramë sa historike aq dhe konkrete në lidhje me të tilla sprova në kontekstin shqiptar mund të konstatohet se janë përpiluar dhe kanë parë dritën e shtypit mjaft vepra dhe trajtesa që kishin në qendër të vëmendjes pikërisht liturgjinë dhe aspektet themelore të receptimit të saj te meshtarët dhe besimtarët.

Së fundi, vetë larmia e pasuria gjuhësore e sipërcituar në lidhje me variantet doktrinare që dëshmojnë përpjekje të vazhdueshme për të përruar nëpërmjet gjuhës shqipe dhe arsenalit të saj një kulturë e një traditë besimi dhe në vendin tonë, mund të bëjë të mundur të rindërtohet dhe një panoramë gjeografike aspak e rastësishme që lidhet drejtpërdrejt me historinë e besimit të krishterë në viset shqiptare dhe me atë të dioqezave kishtarë përkatëse. Ndërtime që ruajnë vlera poetike unike, zhvillime gjuhësore, por dhe të gjinive shkrimore të përcaktuara gjejnë vijimësi pikërisht nëpërmjet realizimesh të

---

<sup>2</sup> Konciziteti në përmbajtje nuk ka kushtëzuar aspak veçori dhe elemente origjinale që i atribuohen vepërës në fjalë sa herë që trajtohet kjo e fundit në këndvështrime që piren nga historia e shkrimit shqip dhe ajo e letërsisë së shkruar shqipe.

tilla, që shënojnë para së gjithash dhe arritje në pikëpamje të konsolidimit të një tradite shkrimore që vijon të mbetet e veçantë në përmbajtje dhe në ekzemplarët që e përfaqësojnë atë.

## BIBLIOGRAFI

- Ashta, K., *Rreth disa çështjeve të leksikut të Pjetër Budit*, në “Studime filologjike”, 1966/4.
- Bardhi, F., *Fjalor latinisht-shqip 1635*, (përgatiti E. Sedaj), Prishtinë, 1983.
- Bardhi P. O.F.M., *Libri i D. Gjon Buzukut*, në *Zâni i Shna Ndout*, nr. II, 1920.
- Blaise, A., *Manuel du latin chrétien*, Brépols, Strasbourg, 1955.
- Bogdani, P., *Cuneus prophetarum (botim kritik përgatitur nga A. Omari)*, Tiranë, 2005.
- Borgia, N., *Pericope evangelica in lingua albanese del secolo XIV (da un Manoscritto Greco della Biblioteca Ambrosiana)*, Scuola Tipografica Italo-Orientale «San Nilo», Grottaferrata, 1930.
- Borgia, N., *Frammenti eucaristici antichissimi (Saggio di poesia sacra popolare bizantina)*, Scuola Tipografica dell’Abbazia, 1932.
- Budi, P., *Dottrina Christiana (1618), with a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane*, Institut for Lingvistik, Aarhus, 1985.
- Budi, P., *Poezi (Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R. Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Camaj, M., *Il “Messale” di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, në “Shêjzat”, Romë, 1960.
- Camaj, M., *Pjetër Budi (në rasën e katërqindvjetorit të lindjes)*, në “Shêjzat”, nr. 9-12, 1966.
- Carmassi, P., *Libri liturgici e istituzioni ecclesiastiche a Milano in età medioevale (studio sulla formazione del lezionario ambrosiano)*, Aschendorff Münster, 2001.
- Çabej, E., *Elemente të gjuhës e të literaturës shqipe*, Tiranë, 1936.
- Çabej, E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kriteret rreth botimit të tyre*, në BUSHT, nr. 2, 1959.
- Çabej, E., *Pjetër Budi dhe gjuha e tij*, në “Studime filologjike”, 1966/4.
- Çabej, E., *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*, “Nëndori”, 1955, nr. 3.
- Çabej, E., *Studime gjuhësore VI*, Botime Rilindja, Prishtinë, 1977.
- Çabej, E., *Vepra e Gjon Buzukut në vështrim gjuhësor historik*, në “Studime filologjike”, 1979/1.
- Çabej, E., *Shqipja në kapërcyell/Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.

- Demiraj, B., *Gjon Nikollë Kazazi dhe "doktrina" e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Demiraj, B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ, 1635), per R. D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- Demiraj, B., *Rrënjë dhe degë të krishtërimin ndër shqiptarë*, në "Hylli i Dritës", nr.2, 2011.
- Demiraj, B., *Jetë rishtarësh shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Feros (1663-1746)*, në "Hylli i Dritës", nr. 1-2, 2015.
- Demiraj, B., *Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. I. Frang Mark Bardhi (1606-1643)*, në "Hylli i Dritës", nr. 1, 2016.
- Demiraj, B., *Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. II. Andrea Bogdani (1607-1683); III. Rinia dhe formimi teologjik-intelektual i Pjetër Bogdanit; IV. Gjergj Toliq si hartues i Letrës së Pleqve të Gashit (1689)*, në "Hylli i Dritës", nr. 2, 2016.
- Demiraj, B., *Enciklika "Inter Omnigenas" e Papë Benediktit XIV (2 shkurt 1744) dhe roli i Imzot Gjon P. Nikollë Kazazit në përfitim të saj*, në "Shêjzat-Pleiades", nr. 1-2, 2016.
- Demiraj, B., *Areali kulturor i Veriut në shek. XVI-XIX*, Botime Onufri, Tiranë, 2017.
- Domi, M., *PjetërBudi (1566-1622)*, në "Studime filologjike", 1966/4.
- Fishta, F., *Nder gjurmimet e veprimt "De propaganda fide" në Balkan*, në "Hylli i Dritës", nr. 7-8, 1932.
- Ismajli, R., *Tekste të vjetra*, Botime Dukagjini, Pejë, 2000.
- Jorgaqi, K., *Ndikimi i italishtes në letërsinë e vjetër shqipe (XVI-XVII)*, Botime Toena, Tiranë, 2001.
- Lacaj, H., *Pjetër Budi, vjershëtor i parë i letërsisë sonë*, në "Studime filologjike", 1966/4.
- Kamsi, K., *Frangu i Bardhë (1606-1643)*, në "Buletin i shkencave shoqërore", nr. 2, 1956.
- Marlekaj, L., *Doli libri më i vjetri i gjuhës shqipe*, në "Shêjzat", nr. 1-2, 1959.
- Marlekaj, L., *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo*, Liantonio editore, Palo del Colle, Bari, 1989.
- Mjedja, D. N., *Çashtje gjuhe: një dorëshkrim i moçëm e një kritike e re*, në "Leka", 1933.
- Nadin, L., *Ancora sul Meshari di Gjon Buzuku. Nuovi dati e nuovi scenari*, në "Hylli i Dritës", nr. 1-2, 2015.
- Omari, A., *Botimi kritik i "Mesharit" të Gjon Buzukut- dy versione në ballafaqim*, në "Studime filologjike", 2008/3-4.
- Omari, A., *Disa risi në fushën e botimit të teksteve të vjetra shqipe*, në Konferenca shkencore: "Çështje të studimeve diakronike të shqipes", ASHAK, 2009.

- Omari, A., *Kontributi i "Hyllit të Dritës" në studimet filologjike shqiptare*, në "Hylli i Dritës", numër jubilar me rastin e 100-vjetorit, Shkodër, 2013.
- Paci, E., *Për një vështrim tekstologjik të Mesharit të Gjon Buzukut*, në "Hylli i Dritës", nr. 3, 2011.
- Paci, E., *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011.
- Paci, E., *Kolofoni në Mesharin e Gjon Buzukut*, në "Hylli i Dritës", nr. 1, 2012.

## SUMMARY

### EARLY DOCTRINAL VARIANTS IN THE CONTEXT OF THE HISTORY ON ALBANIAN WRITTEN LITERATURE

The doctrinal versions as a subject of this article are works that mark real important achievements in the history of Albanian writing and book culture in Albanian. These are catechetical handbooks that chronologically follow the publication of Gjon Buzuku's book (1555), while making it possible to trace other reference models that have served to compile or adapt such works. Six hundred, the century of the publication of the doctrine of the Covenant of Pjeter Budi (Rome, 1618) is impregnated with events associated with fundamental changes both in the conception of the transmission of doctrinal notions and in the self-publishing of books representing Roman ritual, breviary etc. It is also noted in this article the importance of studying the publications and reprints of specimens related to the Christian faith and the daily liturgy, as well as the continued use of a specific terminology for the daily practice of this liturgy. Of particular interest is the contribution of Gjon Nikollë Kazazi (1743), but also the efforts of other authors despite they compiled their modest works some centuries later, retained in general the essential elements of a time-initiated liturgical and theological lexicon before.